



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 627/13 prot

Datë 02.07.2024

V E N D I M

Nr. 791/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.07.2024 me

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-92041-12-22-2023, me objekt: Loti 1 “*Marrje Mjetesh Rrugore me Qira Operacionale (leasing), autoveturë elektrike*”, me fond limit 252,325,080 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 25.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tiranë, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albania Car Rentals” SHPK, me NIPT (K92311013D), me adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Vaso Pasha”, Nr.75, Tiranë.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK, me NIPT (K82318007Q), me adresë: Autostrada Tiranë – Durrës, Km 1, Rruga Dytësore, Kashar, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26.12.2023, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-92041-12-22-2023, me objekt: Loti 1 “Marrje Mjetesh Rrugore me Qira Operacionale (leasing), autoveturë

elektrike”, me fond limit 252,325,080 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 25.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 19.02.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|------------------------------|-------------------------------|
| 1. “Tirana Auto” SHPK | 214,200,000 lekë, kualifikuar |
| 2. “Albania Car Rental” SHPK | 227,092,500 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 29.02.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraparak në SPE.

II.4. Në datën 11.03.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/3895, datë 11.03.2024, dhe me nr. protokollit 627/2024, e operatorit ekonomik “Albania Car Rentals” SHPK, për procedurën e prokurimit.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK. Konkretisht në ankesën e tij, operatori ekonomik ankimes pretendon:

“[...] Nisur nga sa me sipër, kjo diferencë cmimi shpjegohet vetëm me faktin se kjo kompani ka ofertuar model makine që nuk plotson specifikimet teknike dhe konkretisht dy specifikime bëjnë diferencën e cmimit dhe konkretisht parametri “KOHËZGJATJA E KARIKIMIT I PLOTE PRIZË NORMALE 0-100%” dhe parametri “DISTANCA MAKSIMALE ME NJË KARIKIM”.

Pretendimi I: Kërkojmë skualifikimin e ofertës së kompanisë Tirana Auto pasi nuk plotëson kriterin kualifikues të pikës 2.3.3 të Shtojcës 7 LOTI 1: “MARRJE MJETESH RRUGORE ME QIRA OPERACIONALE (LEASING), AUTOVETURË ELEKTRIKE” të dokumenteve të tenderit.

Ne këto kriter kualifikues, AK-ja ka kërkuar si më poshtë:

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun teknik, në të cilin të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët/ fragmente që i përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë në gjuhën/gjuhët e përcaktuara në DST.

Ne Shtojcën 5 LOTI 1: “MARRJE MJETESH RRUGORE ME QIRA OPERACIONALE (LEASING), AUTOVETURË ELEKTRIKE” të dokumenteve të tenderit AK-ja ka përcaktuar specifikimet teknike minimale të makines elektrike që kërkon të marrë me qira, si më poshtë:

Pra që të plotësojë këto kriter duhet që kompania Tirana Auto të dorëzojë katalogun e modelit të makines elektrike që ofron, si dhe njëkohësisht në këto katalog të markohen të gjitha specifikimet teknike sikurse janë dhënë në Shtojcën 5 dhe njëkohësisht specifikimet teknike të katalogut duhet të jenë të njëjta ose më të mira se specifikimet teknike të Shtojcës 5.

Nisur nga fakti se kjo kompani ka ofertuar me cmim me te ulet, si dhe duke e ditur se cfare modele makinash elektrike tregton kjo kompani ne tregun Shqiptar jemi te bindur se katalogu i makines se ofruar nga ana e kesaj kompanie nuk permbush specifikimet teknike lidhur me parametrin (specifikimin teknik) “KOHËZGJATJA E KARIKIMIT I PLOTE PRIZË NORMALE 0-100%” dhe me parametrin (specifikimin teknik) “DISTANCA MAKSIMALE ME NJË KARIKIM”, pasi keto dy parametra ne makinen eketrike te ofruar prej tyre jane me te ulet se parametrat e kerkuara ne Shtojcen 5 te dokumenteve te tenderit.

Konkretisht:

□ parametrin (specifikimin teknik) “KOHËZGJATJA E KARIKIMIT I PLOTE PRIZË NORMALE 0-100%” ne Shtojcen 5 eshte kerkuar qe te jete jo me shume se 7 (shtate) ore, nderkohe qe modeli i makines elektrike te ofruar prej Tirana Auto shp.k kete parameter në bazë të informacioneve tregëtare që disponojmë si dhe në bazë të analizës së çmimit të ofruar nga kjo shoqëri besojme qe e ka per 11(dymbëdhjete) ore dhe i përket KORANDO E-MOTION i markes SSANGYONG, dhe kjo bindje bazohet në katalogun zyrtar të kompanisë prodhuese e cila referon qartësisht te karakteristikat e saj te referuara aty percaktohet qartë që është 11 ore periudha e karikimit. Nderkohe qe makina e ofruar nga ana jone kete parameter e ka per 5 (pese) ore, çka na penalizon, pasi per te plotesuar kriterin kualifikues ofertuam nje tip makine qe eshte i shtrenjte, ndersa konkurenti Tirana Auto ka ofertuar nje model me te lire, por qe nuk e ploteson kete parameter dhe ne kete rast shkelet PARIMI I BARAZISE NE TENDERA.

□ parametrin (specifikimin teknik) “DISTANCA MAKSIMALE ME NJË KARIKIM” ne Shtojcen 5 eshte kerkuar qe te jete jo me pak se 400 km, nderkohe qe modeli i makines elektrike te ofruar prej Tirana Auto kete parameter besojme qe e ka deri ne 340 km, nderkohe qe makina e ofruar nga ana jone kete parameter e ka 450 km, çka na penalizon, pasi per te plotesuar kriterin kualifikues ofertuam nje tip makine qe eshte i shtrenjte ndersa konkurenti Tirana Auto ka ofertuar nje model me te lire por qe nuk e ploteson kete parameter dhe ne kete rast shkelet PARIMI I BARAZISE NE TENDERA.

Kete pretendim tonin ne e mbeshtesim ne njohurite e tregut, pasi e dime shume mire se e vetmja makine elektrike qe kompani Tirana Auto ka ne dispozicion eshte modeli KORANDO EMOTION i markes SSANGYONG e cila është marka dhe modeli i vetëm që mund të ofronin në bazë të çmimit që kanë ofruar në këtë procedurë tenderimi.

Gjithashtu ne katalogun e dorezuar nga kompania Tirana Auto nuk gjejne pasqyrim te gjitha specifikimet teknike te Shtojces 5 te dokumenteve te tenderit. Për të qënë më të kujdesshëm në lidhje me këto kritere po ju vëmë në dispozicion dhe në format elektronik dhe katalogun zyrtar të KORANDO E-MOTION i markes SSANGYONG të marrë në faqen zyrtare të kompanisë dhe më konkretisht https://www.kg-mobility.com/en/SHOËROOM/korando-emotion/sn_sr_9_file/E100LHDCatalog.pdf.

Persa me siper kerkojme skualifikimin e ofertes se kompanise Tirana Auto, pasi nuk ploteson kriterin kualifikues te pikes 2.3.3 te Shtojces 7 te DST-ve.

Pretendimi II: Kerkojme skualifikimin e ofertes se kompanise Tirane Auto pasi nuk ploteson kriterin kualifikues te pikes 2.3.2 te Shtojcs 7 LOTI 1: “MARRJE MJETESH RRUGORE ME QIRA OPERACIONALE (LEASING), AUTOVETURË ELEKTRIKE” te dokumenteve te tenderit.

Ne kete kriter kualifikues, AK-ja ka kerkuar si me poshte:

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar mbi të drejtat e realizimit të furnizimit me llojin e mjetit të ofruar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar me prodhuesin.*

-Forma e Dokumentit: Autorizimi duhet të paraqitet në gjuhën/gjuhët e përcaktuara në DST dhe përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: adresën; telefon/fax; email, Website, këto të nevojshme për AK në rast verifikimi. Në rast se Autorizimi nuk përmban këto të dhëna, do të konsiderohet i pavlefshëm.

Shënim: Autoriteti Kontraktor gjatë fazës së kualifikimit mund të kryejë verifikimin e të dhënave të paraqitura në Autorizimin e Prodhuesit.

Sikurse përmendem edhe me sipër, e vetmja makine elektrike që shet aktualisht kompania Tirana Auto janë makinat elektrike të markës SSANGYONG.

Prodhuesi i këtyre makinave është kompania Koreane Jugore KGM me adresë WEBSITE www.kg-mobility.com.

Kompania Tirana Auto nuk e ka plotësuar kriterin kualifikues të pikës 2.3.2 sepse nuk ka dorëzuar autorizim prodhuesi të leshuar nga kompania prodhuese Koreane Jugore KGM, pasi kjo kompani nuk leshon autorizim prodhuesi.

Nisur nga ky fakt, kompania Auto Tirana duhet të ketë dorëzuar Autorizim Distributori të Autorizuar, por nuk ka dorëzuar asnjë dokument të leshuar nga kompania prodhuese Koreane Jugore KGM që të vërtetojë lidhjen midis këtij prodhuesi dhe distributorit të autorizuar.

Përsa me sipër kërkojmë skualifikimin e ofertës së kompanisë Tirana Auto, pasi nuk plotëson kriterin kualifikues të pikës 2.3.2 të Shtojcës 7 të DST-ve.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 627 Prot., datë 12.03.2024, lidhur me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.6. Në datën 19.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 612/3, operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK, ka paraqitur pranë KPP-së Formularin e Paraqitjes së Argumenteve, si operator ekonomik i interesuar.

II.7. Me shkresën nr. 10861/2 prot, datë 25.03.2024, me objekt: “Kthim - përgjigje ankesës së bërë nga operatori ekonomik “Albania Car Rentals” SHPK dhe argumenteve të paraqitura nga operatori ekonomik i interesuar “Tirana Auto” SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: Loti 1 “Marrje mjetesh rrugore me qira operationale (leasing), autoveturë elektrike”, me Nr. REF-92041-12-22-2023”, protokolluar me tonën me nr. 627/5 prot. datë 15.04.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Albania Car Rentals” SHPK, ku konstatohet, se ankesa e këtij të fundit është refuzuar.

II.8. Në datën 14.06.2024, nëpërmjet shkresës me nr. 627/8 prot., datë 13.06.2024 (në gjuhën angleze protokolluar me nr. 627/9 prot., datë 13.06.2024), KPP me qëllim shqyrtimin e të gjitha fakteve, iu drejtua nëpërmjet adresës së emailit KPP_info@kpp.gov.al, me një kërkesë për informacion, prodhuesit SSANGYONG MOTOR COMPANY, KG MOBILITY, në adresat e emailit (symc_ir@smotor.com/ joonbum.kim@smotor.com/ kihun1.kim@smotor.com) dhe distributorit të autorizuar SYMI S.P.A, në adresën e emailit (info@ssangyong-italia.it), me përmbajtje si më poshtë:

“[...]”

Gjatë shqyrtimit të një ankese, për një procedurë prokurimi, një subjekt pjesëmarrës ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Dokumentin “Autorizim distributori”, ku subjekti SYMI S.P.A (Vat 04026110967), me seli në Milano (MI-20156), Rruga “Varesina”, 162, si importues dhe distributor i makinave të prodhuara nga SsangYong Motor Company, në Itali dhe Shqipëri, autorizon operatorin ekonomik pjesëmarrës në tender “Tirana Auto” SHPK me seli në Tiranë (Autostrada Tiranë – Durrës, Km.1) për shitjen dhe servisin e makinave SsangYong.
- Dokumentin “Importer/Distributorship Agreement” midis Ssangyong Motor Company me adresë 150-3, Chilko-dong, Pyungtaek-si, 459-050 Korea (SYMC) dhe “SYMI” S.R.L me adresë Viale dell’Industria, 23/25, 20010, Pregnana Milanese, Milano, Itali.
- Katalog për modelin e automjetit “Korando”, KGM Motors, shoqëruar me përkthimin në gjuhën shqipe. (bashkëlidhur dokumenti - 14 faqe)

Gjatë shqyrtimit të ankesës lind e nevojshme informacioni juaj, në lidhje me specifikimet teknike të kërkuara për këtë procedurë, konkretisht:

Sa është kohëzgjatja e karikimit të plotë prizë normale 0 – 100 % dhe distanca maksimale me një karikim, për automjetin sipas modelit në katalogun bashkëlidhur kësaj shkrese.

“[...]”

“ [...]”

During the review of a complaint regarding a procurement procedure, a participating entity has submitted the following documentation:

- The document "Distributor Authorization", Where the entity SYMI S.P.A (Vat 04026110967), based in Milan (MI-20156), Varesina Street, 162, as the importer and distributor of vehicles manufactured by SsangYong Motor Company, in Italy and Albania, authorizes the economic operator participating in the tender "Tirana Auto" SHPK based in Tirana (Tirana - Durrës Highway, Km.1) for the sale and service of SsangYong vehicles.
- The document "Importer/Distributorship Agreement" between Ssangyong Motor Company with address 150-3, Chilko-dong, Pyungtaek-si, 459-050 Korea (SYMC) and “SYMI” S.R.L with address Viale dell’Industria, 23/25, 20010, Pregnana Milanese, Milan, Italy.
- Catalog for the vehicle model "Korando", KGM Motors, accompanied by the translation in the Albanian language. (Attached document – 14 pages)

During the review of the complaint, your information is necessary, regarding the technical specifications required for this procedure, as below:

What is the “duration of a full charge normal plug 0 - 100 %” and “the maximum distance with one charge”, for the vehicle according to the model in the catalog attached to this document.

[...]”.

III.9. Në datën 28.06.2024, në postën elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik Kpp_info@kpp.gov.al, protokolluar me tonën me nr. 627/10 prot., datë 28.06.2024, ka mbërritur kthim - përgjigje nga diego.fiorenzoli@koelliker.it, me përmbajtje si më poshtë:

“Dear Sirs,

following your below request, we send you hereby attached our official answer.

We are available for any additional inquiry about this topic.

Kind regards.

Diego Fiorenzoli

/ Customer Experience Director

.....

as required, We hereby inform you about technical specifications of the vehicle Korando InMotion (EV version of Korando).

EV Battery: 61,5 kwh

AC charging (“slow charge”), with 6,6kwh on-board-charger, from 0% to 100%:

- Using cable with Type-2 plug – charging time: +/- 11 hours*
- Using domestic cable with Schuko plug – charging time: +/- 30 hours*
- Both cables are embedded with the neë vehicle*

DC charging (“fast charge”) up to 100kwh, from 20% to 80%:

- Using Combo-CCS2 connector*
- Charging time: +/- 33 minutes*

Range

- City/Urban usage: 498 km*
- Combined average usage (WLTP): 340 km*

Hope above information can help you.

We are available for any additional explanation about vehicle specifications.

Best regards

SYMI S.P.A.

Customer Experience & After-Sales Director

Diego Fiorenzoli

[...]”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Albanian Car Rentals” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Tirana Auto” SHPK, me argumentin se “[...] Kompania Tirana Auto nuk e ka plotësuar kriterin kualifikues të pikes 2.3.2 sepse nuk ka dorezuar autorizim prodhuesi të leshuar nga kompania prodhuese Koreane Jugore KGM, pasi kjo kompani nuk leshon autorizim prodhuesi.

Nisur nga ky fakt, kompania Auto Tirana duhet të ketë dorezuar Autorizim Distrutori të Autorizuar, por nuk ka dorezuar asnjë dokument të leshuar nga kompania prodhuese Koreane Jugore KGM që të vërtetojë lidhjen midis këtij prodhuesi dhe distributorit të autorizuar.

Per sa me siper, kerkojme skualifikimin e ofertes se kompanise Tirana Auto, pasi nuk ploteson kriterin kualifikues te pikes 2.3.2 te Shtojces 7 te DST-ve.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Loti 1, Shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

“2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar mbi të drejtat e realizimit të furnizimit me llojin e mjetit të ofruar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar me prodhuesin.

-Forma e Dokumentit: Autorizimi duhet të paraqitet në gjuhën/gjuhët e përcaktuara në DST dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: adresën; telefon/fax; email, Website, këto të nevojshme për AK në rast verifikimi. Në rast se Autorizimi nuk përmban këto të dhëna, do të konsiderohet i pavlefshëm.

Shënim: Autoriteti Kontraktor gjatë fazës së kualifikimit mund të kryejë verifikimin e të dhënave të paraqitura në Autorizimin e Prodhuësit.”

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Tirana Auto” SHPK, rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

- Dokumentin “Autorizim distributori”, datë 11.01.2024, me përmbajtje “Ne SYMI S.P.A (Vat 04026110967), me seli në Milano (MI-20156), Rr. “Varesina”, 162, përfaqësuar nga Z. G.L, president ekzekutiv dhe administrator i përgjithshëm, si prodhues, importues dhe distributor me ekskluzivitet për Italinë dhe Shqipërinë i makinave, servisit dhe pjesëve të këmbimit të makinave SsangYong Motor, Konfirmojmë që: Ne autorizojmë “Tirana Auto”

SHPK me adresë Autostrada TR – DR KM 1, Tiranë/Shqipëri për shitjen e automjeteve, servisit dhe pjesët e këmbimit". (dokument i përkthyer dhe noterizuar).

- Dokumentin “Marrëveshje importuesi/Shpërndarësi” midis Ssangyong Motor Company me adresë 150-3, Chilkoi-dong, Pyungtaek-si, 459-050 Korea (SYMC) dhe “SYMI” S.R.L me adresë Viale dell’Industria, 23/25, 20010, Pregnana Milanese, Milano, Itali, si Importues, nënshkruar nga të dyja palët. (dokument i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar);
- Katalog për modelin e automjetit “Korando”, KGMobility, shoqëruar me përkthimin në gjuhën shqipe.

III.1.3. Neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.4. Në nenin 40, pika 6/c dhe 8 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

[...]

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë, se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, ka kërkuar shprehimisht, që “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar mbi të drejtat e realizimit të furnizimit me llojin e mjetit të ofruar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar me prodhuesin.

-Forma e Dokumentit: Autorizimi duhet të paraqitet në gjuhën/gjuhët e përcaktuara në DST dhe përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: adresën; telefon/fax; email, Website, këto të nevojshme për AK në rast verifikimi. Në rast se Autorizimi nuk përmban këto të dhëna, do të konsiderohet i pavlefshëm.”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur dokumentin Autorizim nga Distributori SYMI S.P.P, në të cilin deklarohet se ky i fundit si prodhues, importues dhe distributor me ekskluzivitet për Italinë dhe Shqipërinë, i makinave, servisit dhe pjesëve të këmbimit të makinave SsangYong Motor, autorizon operatorin ekonomik “Tirana Auto” SHPK për shitjen e këtyre automjeteve, servisin dhe pjesët e këmbimit për to. Ky dokument është dorëzuar në origjinal në gjuhën angleze, si dhe një kopje e noterizuar dhe e përkthyer në gjuhën shqipe. Gjithashtu, në përmbushje të kriterit të kualifikimit, operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK ka dorëzuar në SPE dokumentin “Marrëveshje importuesi/Shpërndarësi” midis Ssangyong Motor Company me adresë 150-3, Chilko-dong, Pyungtaek-si, 459-050 Korea (SYMC) dhe “SYMI” S.R.L me adresë Viale dell’Industria, 23/25, 20010, Pregnana Milanese,

Milano, Itali, si Importues, nënshkruar nga të dyja palët. (dokument i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar), ku nga verifikimi i tij, konstatohet, se është paraqitur tabela e përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje, parathënia dhe përkufizimet. Por në këtë dokument pasqyrohen të dhënat e prodhuesit si: adresën; telefon/fax; etj.

Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, se *“nuk ka dorëzuar asnjë dokument të lëshuar nga kompania prodhuese Koreane Jugore KGM që të vërtetojë lidhjen midis këtij prodhuesi dhe distributorit të autorizuar”*, KPP nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, gjykon, se ky i fundit ka dorëzuar dokumentin *“Marrëveshje importuesi/Shpërndarësi”*, midis prodhuesit Ssangyong Motor Company (SYMC) dhe distributorit *“SYMI” S.R.L*, dokument, i cili vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit. Gjithashtu, KPP me qëllim shqyrtimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, bëri verifikime në faqen zyrtare të WEB të prodhuesit Ssangyong Motor Company (kg-mobility.com) dhe konstatoi, se SYMI S.P.A Italy, është distributor i prodhuesit Ssangyong Motor Company.

Me qëllim shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, KPP lidhur me verifikimin e disa specifikimeve teknike (argumentuar në pikën III.2. e në vijim të këtij vendimi), komunikoi nëpërmjet korrespondencës me email me distributorin SYMI S.P.A, ku ky i fundit ka trajtuar kërkesën e Komisionit të Prokurimit Publik, mbi specifikimet teknike për automjetin e modelit *“Korando”*, të prodhuesit Ssangyong Motor Company (SYMC), aktualisht me emrin KGMobility, si distributor i autorizuar i këtij prodhuesi.

Akoma më tej, në kriterin e kualifikimit, vetë autoriteti kontraktor ka përcaktuar që *“Autoriteti Kontraktor gjatë fazës së kualifikimit mund të kryejë verifikimin e të dhënave të paraqitura në Autorizimin e Prodhuesit”*, pra autoriteti kontraktor në çdo moment gjatë fazës së kualifikimit mund të verifikojë vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik fitues.

Sa më sipër, gjykojmë, se operatori ekonomik *“Tirana Auto” SHPK* me dokumentacion e paraqitur, përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.2 të *“Kritereve të Veçanta të Kualifikimit”*, të dokumenteve të tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik *“Albanian Car Rentals” SHPK*, për skualifikimin e operatorit ekonomik *“Tirana Auto” SHPK*, me argumentin se *“[...] Nisur nga fakti se kjo kompani ka ofertuar me cmim me te ulet, si dhe duke e ditur se çfare modele makinash elektrike tregton kjo kompani ne tregun Shqiptar jemi te bindur se katalogu i makines se ofruar nga ana e kesaj kompanie nuk permbush specifikimet teknike lidhur me parametrin (specifikimin teknik) “KOHËZGJATJA E KARIKIMIT I PLOTE PRIZË NORMALE 0-100%” dhe me parametrin (specifikimin teknik) “DISTANCA MAKSIMALE ME NJË KARIKIM”, pasi keto dy parametra ne makinen eketrike te ofruar prej tyre jane me te ulet se parametrat e kerkuara ne Shtojcen 5 te dokumenteve te tenderit. Konkretisht:*

□ parametrin (specifikimin teknik) *“KOHËZGJATJA E KARIKIMIT I PLOTE PRIZË NORMALE 0-100%”* ne Shtojcen 5 eshte kerkuar qe te jete jo me shume se 7 (shtate) ore, nderkohe qe modeli i makines elektrike te ofruar prej Tirana Auto shp.k kete parameter në bazë të informacioneve tregëtare që disponojmë si dhe në bazë të analizës së çmimit të ofruar nga

kjo shoqëri besojme qe e ka per 11(dymbëdhjete) ore dhe i përket KORANDO E-MOTION i markes SSANGYONG, dhe kjo bindje bazohet në katalogun zyrtar të kompanisë prodhuese e cila referon qartësisht te karakteristikat e saj te referuara aty percaktohet qartë që është 11 ore periudha e karikimit. Nderkohe qe makina e ofruar nga ana jone kete parameter e ka per 5 (pese) ore, çka na penalizon, pasi per te plotesuar kriterin kualifikues ofertuam nje tip makine qe eshte i shtrenjte, ndersa konkurenti Tirana Auto ka ofertuar nje model me te lire, por qe nuk e ploteson kete parameter dhe ne kete rast shkelet PARIMI I BARAZISE NE TENDERA.

□ parametrin (specifikimin teknik) “DISTANCA MAKSIMALE ME NJË KARIKIM” ne Shtojcen 5 eshte kerkuar qe te jete jo me pak se 400 km, nderkohe qe modeli i makines elektrike te ofruar prej Tirana Auto kete parameter besojme qe e ka deri ne 340 km, nderkohe qe makina e ofruar nga ana jone kete parameter e ka 450 km, çka na penalizon, pasi per te plotesuar kriterin kualifikues ofertuam nje tip makine qe eshte i shtrenjte ndersa konkurenti Tirana Auto ka ofertuar nje model me te lire por qe nuk e ploteson kete parameter dhe ne kete rast shkelet PARIMI I BARAZISE NE TENDERA.

Kete pretendim tonin ne e mbeshtesim ne njohurite e tregut, pasi e dime shume mire se e vetmja makine elektrike qe kompani Tirana Auto ka ne dispozicion eshte modeli KORANDO EMOTION i markes SSANGYONG e cila është marka dhe modeli I vetëm që mund të ofronin në bazë të çmimit që kanë ofruar në këtë procedurë tenderimi.

Gjithashtu ne katalogun e dorezuar nga kompania Tirana Auto nuk gjejne pasqyrim te gjitha specifikimet teknike te Shtojces 5 te dokumenteve te tenderit. Për të qënë më të kujdesshëm në lidhje me këto kritere po ju vëmë në dispozicion dhe në format elektronik dhe katalogun zyrtar të KORANDO E-MOTION i markes SSANGYONG të marrë në faqen zyrtare të kompanisë dhe më konkretisht https://www.kg-mobility.com/en/SHOWROOM/korando-emotion/sn_sr_9_file/E100LHDCatalog.pdf.

Persa me siper kerkojme skualifikimin e ofertes se kompanise Tirana Auto, pasi nuk ploteson kriterin kualifikues te pikes 2.3.3 te Shtojces 7 te DST-ve.[...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, Loti 1, Shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

“2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun teknik, në të cilin të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët/ fragmente që i përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë në gjuhën/gjuhët e përcaktuar në DST.”

III.2.2. Në dokumentet e tenderit, Loti 1, Shtojca 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Kërkesat teknike për autoveturë elektrike 4+1 vende:

Viti i Prodhimit	2022-2023
Kilometrazhi	0 km
Motorri	Elektrik
Fuqia Totale	Min 140 KË (190PS)

<i>Kambio</i>	<i>Automatike</i>
<i>Tërheqja</i>	<i>2 X 4</i>
<i>Konsumi i Kombinuar</i>	<i>Max 267 Wh/ Km</i>
<i>Emetimi i Gazrave CO2</i>	<i>0 g/Km</i>
<i>Përmasat e makinës:</i>	
<i>Gjatësia</i>	<i>Jo më pak se 3.600 mm</i>
<i>Gjërësia pa pasqyra</i>	<i>Jo më pak se 1.600 mm</i>
<i>Lartësia</i>	<i>Jo më pak se 1.400 mm</i>
<i>Distanca aksiale</i>	<i>Jo më pak se 2.400 mm</i>
<i>Kabina:</i>	
<i>Numri i dyerve</i>	<i>4 + 1</i>
<i>Numri i vendeve</i>	<i>4 + 1</i>
<i>Tipi i baterisë</i>	<i>Lithium-ion</i>
<i>Kapaciteti Nominal I Baterisë</i>	<i>Jo më pak se 55 Kwh</i>
<i>Kohëzgjatja e karikimit I plote prizë normale 0-100%</i>	<i>Jo më shumë se 7 ore</i>
<i>Pesha boshe e makinës</i>	<i>Jo më pak se 1600 kg</i>
<i>Shpejtësia Maksimale</i>	<i>Jo më pak se 130 km/h</i>
<i>Distanca maksimale me një karikim</i>	<i>Jo më pak se 400 Km</i>
<i>Lënda djegëse</i>	<i>Energji Elektrike</i>
<i>Aksesorë shtesë:</i>	
<i>Airbag min 6 cope</i>	
<i>ABS+ ESC+ HAC</i>	
<i>Kontroll Automatik i Dritareve</i>	
<i>Mbyllje qendrore me pult</i>	
<i>Xhamat elektrike</i>	
<i>Dritat elektrike</i>	
<i>Dritat Led</i>	
<i>Ndezje makinës pa çelës</i>	
<i>Timon Multifunksional</i>	
<i>Bluetooth</i>	
<i>Kontroll shpejtësie (Cruise Control)</i>	
<i>Klimatronik</i>	
<i>Sensor parkimi</i>	
<i>Sistem Kamera(mbrapa)</i>	
<i>Radio me AUX + USB</i>	

* Në respektim të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Kontroll i plotë mbi flotën

Institucioni duhet të ruaj të drejtën të ketë kontroll të plotë mbi flotën. Kompania operationale ia mundëson teknikisht institucionit kontrollin mbi flotën e tij me anë të sistemeve GPS dhe sistemeve të menaxhimit të flotës.

Nëpërmjet sistemit GPS të inkomporuar, institucioni ka mundësinë të ketë kontroll të plotë mbi lëvizjen dhe mënyrën e përdorimit të makinave, sipas standardeve të industrisë.

Flota e makinave qëndron në punë 365 ditë të vitit 24/7.

Automjeti është një mjet pune që është ndërtuar për të lehtësuar punën e përdoruesit. Një defekt i automjetit nuk duhet të ndalojë aktivitetin për asnjë arsye. Marja me qira operationale (leasing) e mjeteve ofron programin e zëvendësimit të menjëhershëm të mjetit me një tip tjetër, të ngjashëm ose të njëjtë deri sa defekti në automjet të jetë riparuar dhe mjeti të jetë gati për përdorim. Kontraktori duhet të marrë masë për krijimin e rezervës së mjeteve për këto raste.

Ruajtje e imazhit profesional

Marja me qira e mjeteve do të jetë për një periudhë tre vjeçare, (0 deri në 3 vjet), pra do të meren me zero km dhe do të jenë në përdorim të qiramarrësit për tre vjet me një planifikim vjetor jo më pak se 25 000 km. Kjo do të mundësojë efikasitet dhe ruajtje të imazhit të institucionit.

Mbi këtë vlerësim Bashkia Tiranë ka planifikuar marrjen me qira operationale të një sasive mjetesh rrugore.

MËNYRA E OPERIMIT:

- a. Institucioni përcakton nevojat e tij për makina.*
- b. Kompania ofron makinat e kërkuara në një kontratë 3 vjeçare (36 muaj).*
- c. Makinat nuk figurojnë si asete të institucionit që i merr me qira, pronar i mjetit mbetet qiradhënësi.*
- d. Gjatë këtyre 3 vjetëve detyrimi i vetëm i institucionit është furnizimi me energji elektrike i baterisë së mjetit dhe kryerja e aktivitetit të tij.*
- e. I gjithë menaxhimi i flotës së institucionit kryhet nga kompania operationale.*

*Për aplikimin e suksesshëm të kësaj forme të përdorimit të mjeteve, **menaxhimi dhe mbulimi me shpenzimet e tij i pagesave në lidhje me to, gjatë gjithë periudhës së kontratës**, nga kompania duhet të përfshijë:*

A. Kërkesa të përgjithshme

- a. Të gjithë dokumentacionin e makinës përfshirë, lejen e qarkullimit, regjistrimin, nxjerrjen e targave, taksat vjetore dhe periodike, kontrollit teknik vjetor etj., si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me mjetin (taksa lokale apo të përgjithshme, pronësie etj);*
- b. Të gjithë procesin e sigurimeve përfshirë: siguracionin TPL, kasko, karton jeshil dhe detyrimeve që rrjedhin në rast nevojash;*
- c. Menaxhimin e aksidenteve dhe situatave që vijnë si pasojë e aksidenteve përfshirë: asistencën e menjëhershme rrugore, njerëzore, tërheqjen e makinës deri në pikën më të afërt të riparimit;*
- d. Menaxhimin e ripërtëritjes së përvitshme të dokumenteve shtetërore dhe teknike, si dhe mbulimin me shpenzimet e tij të pagesave në lidhje me to;*
- e. Kryerjen e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve;*
- f. Kryerjen e riparimeve jo-rutinë në rast nevoje;*

- g. Dhënie e makinës zëvendësuese (me të njëjtat parametra ose me të mira) në të gjitha rastet e aksidenteve dhe riparimeve;
- h. Të marrë masa për zëvendësimin e automjetit deri në riparimin final në rast defekti;
- i. Menaxhim flote me anë të inkorporimit të sistemit GPS;
- j. Makinat duhet detyrimisht të jenë ngjyrë e bardhë dhe me logo sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

B. Kërkesa të veçanta

- a. Mjetet që do të ofrohen të jenë prodhim i 2 (dy) viteve të fundit
- b. Dizenjimin e mjeteve me logo sipas porosisë së përdoruesit;
- c. Mjetet që do të ofrohen të jenë të përshtatshme për vendosjen e fenelinave;
- d. Mjetet të jenë të pajisura me konsolle karikimi ÇS (combined charging system)
- e. Mjetet të jenë të pajisura me kabull për karikim publik në AC, si dhe kabull rrjeti për karikim në kushte të tjera;
- f. Automjetet të përmbushin normat dhe standardet e CE.

Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës: Në ambientet e operatorit ekonomik fitues

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Tirana Auto” SHPK, rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

- Dokumenti “Autorizim distributori”, datë 11.01.2024, me përmbajtje “*Ne SYMI S.P.A (Vat 04026110967), me seli në Milano (MI-20156), Rr. “Varesina”, 162, përfaqësuar nga Z. G.L, president ekzekutiv dhe administrator i përgjithshëm, si prodhues, importues dhe distributor me ekskluzivitet për Italinë dhe Shqipërinë i makinave, servisit dhe pjesëve të këmbimit të makinave SsangYong Motor, Konfirmojmë që: Ne autorizojmë “Tirana Auto” SHPK me adresë Autostrada TR – DR KM 1, Tiranë/Shqipëri për shitjen e automjeteve, servisin dhe pjesët e këmbimit*”. (dokument i përkthyer dhe noterizuar).
- Dokumenti “Marrëveshje importuesi/Shpërndarësi” midis Ssangyong Motor Company me adresë 150-3, Chilko-dong, Pyungtaek-si, 459-050 Korea (SYMC) dhe “SYMI” S.R.L me adresë Viale dell’Industria, 23/25, 20010, Pregnana Milanese, Milano, Itali, si Importues, nënshkruar nga të dyja palët. (dokument i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar);
- Katalog për modelin e automjetit “Korando”, KGMobility, shoqëruar me përkthimin në gjuhën shqipe.

III.2.4. Në nenin 36 “*Specifikimet teknike*” të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një

fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet

ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.2.5. Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

III.2.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë, se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin katalogun teknik, në të cilin të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët/ fragmente që i përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë në gjuhën/gjuhët e përcaktuar në DST.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur Katalog për modelin e automjetit “Korando”, KGMobility, shoqëruar me përkthimin në gjuhën shqipe.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, nga verifikimi i katalogut origjinal të dorëzuar nga operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK, konstatohet, se specifikimet teknike për të cilat ankimesi ngre pretendime janë: *Standard charging time (0 to 100%) – Single phase 30h (IC-CPD)/11h (7kw); Fast charge time (20% to 80%) – 100kw: 33 min / 50kw: 54 min; Electric range – km - 339.9; Electric range city – km – 498.4.*

Ndërkohë referuar dokumentit të përkthyer të këtij katalogu, shoqëruar me Vërtetim - përkthim Nr Rep 610, datë 24.01.2024, nga përkthyesi znj. E.F dhe noterizuar nga noteri znj. D.Gj., specifikimet e mësipërme janë përkthyer në gjuhën shqipe si më poshtë citojmë: *Karikim nga 0 – 100 % (11 kw) – 6 orë; Karikim i shpejtë 0 – 80 % - 33 min; Distanca min me një karikim – 498.4.*

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, i cili pretendon se “*jemi te bindur se katalogu i makines se ofruar nga ana e kesaj kompanie nuk permbush specifikimet teknike lidhur me parametrin (specifikimin teknik) “KOHËZGJATJA E KARIKIMIT I PLOTE PRIZË NORMALE 0-100%” dhe me parametrin (specifikimin teknik) “DISTANCA MAKSIMALE ME NJË KARIKIM”, pasi keto dy parametra ne makinën e trike te ofruar prej tyre jane me te ulet se parametrat e kerkuara ne Shtojcen 5 te dokumenteve te tenderit”, si dhe referuar katalogut të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK, së bashku me përkthimin e tij, ku konstatohet mospërputhje, ndërmjet specifikimeve teknike në katalogun origjinal të paraqitur dhe specifikimeve teknike në variantin e përkthyer, KPP me qëllim shqyrtimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, iu drejtua me anë të emailit zyrtar të institucionit tonë, kompanisë prodhuese Ssangyong Motor Company, në Kore (SYMC) dhe distributorit të autorizuar “SYMI” S.P.A, në Itali.*

Konkretisht, në datën 14.06.2024, nëpërmjet shkresës me nr. 627/8 prot., datë 13.06.2024 (në gjuhën angleze protokolluar me nr. 627/9 prot., datë 13.06.2024), KPP me qëllim shqyrtimin e të gjitha fakteve, iu drejtua nëpërmjet adresës së emailit KPP_info@kpp.gov.al me një kërkesë për informacion, prodhuesit SSANGYONG MOTOR COMPANY, KG MOBILITY, në adresat e emailit (symc_ir@smotor.com/ joonbum.kim@smotor.com/ kihun1.kim@smotor.com) dhe distributorit të autorizuar SYMI S.P.A, në adresën e emailit (info@ssangyong-italia.it), me përmbajtje si më poshtë:

“[...]”

Gjatë shqyrtimit të një ankese, për një procedurë prokurimi, një subjekt pjesëmarrës ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Dokumentin “Autorizim distributori”, ku subjekti SYMI S.P.A (Vat 04026110967), me seli në Milano (MI-20156), Rruga “Varesina”, 162, si importues dhe distributor i makinave të prodhuara nga SsangYong Motor Company, në Itali dhe Shqipëri, autorizon operatorin ekonomik pjesëmarrës në tender “Tirana Auto” SHPK me seli në Tiranë (Autostrada Tiranë – Durrës, Km.1) për shitjen dhe servisimin e makinave SsangYong.

- Dokumentin “Importer/Distributorship Agreement” midis Ssangyong Motor Company me adresë 150-3, Chilko-dong, Pyungtaek-si, 459-050 Korea (SYMC) dhe “SYMI” S.R.L me adresë Viale dell’Industria, 23/25, 20010, Pregnana Milanese, Milano, Itali.
- Katalog për modelin e automjetit “Korando”, KGM Motors, shoqëruar me përkthimin në gjuhën shqipe. (bashkëlidhur dokumenti - 14 faqe)

Gjatë shqyrtimit të ankesës lind e nevojshme informacioni juaj, në lidhje me specifikimet teknike të kërkuara për këtë procedurë, konkretisht:

Sa është kohëzgjatja e karikimit të plotë prizë normale 0 – 100 % dhe distanca maksimale me një karikim, për automjetin sipas modelit në katalogun bashkëlidhur kësaj shkrese.

[...]”

“ [...]

During the review of a complaint regarding a procurement procedure, a participating entity has submitted the following documentation:

- The document "Distributor Authorization", Where the entity SYMI S.P.A (Vat 04026110967), based in Milan (MI-20156), Varesina Street, 162, as the importer and distributor of vehicles manufactured by SsangYong Motor Company, in Italy and Albania, authorizes the economic operator participating in the tender "Tirana Auto" SHPK based in Tirana (Tirana - Durrës Highway, Km.1) for the sale and service of SsangYong vehicles.
- The document "Importer/Distributorship Agreement" between Ssangyong Motor Company with address 150-3, Chilko-dong, Pyungtaek-si, 459-050 Korea (SYMC) and “SYMI” S.R.L with address Viale dell’Industria, 23/25, 20010, Pregnana Milanese, Milan, Italy.
- Catalog for the vehicle model "Korando", KGM Motors, accompanied by the translation in the Albanian language. (Attached document – 14 pages)

During the review of the complaint, your information is necessary, regarding the technical specifications required for this procedure, as below:

What is the “duration of a full charge normal plug 0 - 100 %” and “the maximum distance with one charge”, for the vehicle according to the model in the catalog attached to this document.

[...]”.

Gjithashtu, bashkëlidhur emailit të mësipërm, dorëzuar katalogun e dorëzuar nga operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK, modeli “Korando” KGMobility, në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Në datën 28.06.2024, në postën elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik Kpp_info@kpp.gov.al, protokolluar me tonën me nr. 627/10 prot., datë 28.06.2024, ka mbërritur kthim - përgjigje nga diego.fiorenzoli@koelliker.it, me përmbajtje si më poshtë:

“Dear Sirs,

following your below request, We send you hereby attached our official answer.

We are available for any additional inquiry about this topic.

Kind regards.

Diego Fiorenzoli

/ Customer Experience Director

.....

as required, We hereby inform you about technical specifications of the vehicle Korando InMotion (EV version of Korando).

EV Battery: 61,5 kwh

AC charging (“slow charge”), with 6,6kwh on-board-charger, from 0% to 100%:

- Using cable with Type-2 plug – charging time: +/- 11 hours*
- Using domestic cable with Schuko plug – charging time: +/- 30 hours*
- Both cables are embedded with the neë vehicle*

DC charging (“fast charge”) up to 100kwh, from 20% to 80%:

- Using Combo-CCS2 connector*
- Charging time: +/- 33 minutes*

Range

- City/Urban usage: 498 km*
- Combined average usage (WLTP): 340 km*

Hope above information can help you.

We are available for any additional explanation about vehicle specifications.

Best regards

SYMI S.P.A.

Customer Experience & After-Sales Director

Diego Fiorenzoli

III.2.9. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK, si dhe korrespondenca me distributorin e autorizuar, kompaninë SYMI S.P.A, rezulton, se lidhur me specifikimin teknik “*Distanca maksimale me një karikim - Jo më pak se 400 Km*”, konstatohet, se ky i fundit përmbushet nga operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK.

Nga verifikimi i katalogut të modelit “Korando”, të dorëzuar nga operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK, në përmbushje të kriterëve të kualifikimit, konkretisht të specifikimit të mësipërm, rezulton, se *Distanca min me një karikim është 498.4 km*. Gjithashtu, edhe në korrespondencën me distributorin e autorizuar, kompaninë “SYMI” SPA, rezulton se “*City/Urban usage: 498 km*”. Sa më sipër, gjykojmë se modeli i mjetit i paraqitur nga operatori

ekonomik “Tirana Auto” SHPK, përmbush specifikimin teknik lidhur me *Distancën maksimale me një karikim – Jo më pak se 400 km.*

Për sa i përket, specifikimit teknik “*Kohëzgjatja e karikimit i plotë prizë normale 0-100% - jo më shumë se 7 orë*”, KPP nisur nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK, konkretisht të katalogut të paraqitur për modelin “Korando”, i rezulton, se ky specifikim teknik është “***Standard charging time (0 to 100%) – Single phase 30h (IC-CPD)/11h (7kw); Fast charge time (20% to 80%) – 100kw: 33 min / 50kw: 54 min;***”, ndërkohë referuar dokumentit të përkthyer të këtij katalogu, shoqëruar me Vërtetim - përkthimi Nr. Rep 610, datë 24.01.2024, nga përkthyesi znj. E.F dhe noterizuar nga noteri znj. D.Gj., ky specifikim është përkthyer në gjuhën shqipe si më poshtë citojmë: “***Karikim nga 0 – 100 % (11 kw) – 6 orë; Karikim i shpejtë 0 – 80 % - 33 min;***”

Sa më sipër, KPP, nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm, vëren, se ekziston një konfuzion dhe mospërputhje ndërmjet katalogut origjinal të paraqitur nga operatori ekonomik në SPE dhe përkthimit të tij, lidhur me specifikimin *Kohëzgjatja e karikimit i plotë prizë normale 0-100%*.

Për sa më sipër, për shkak të këtij konfuzioni të krijuar, KPP iu drejtua nëpërmjet postës elektronike, në datën 14.06.2024, nëpërmjet shkresës me nr. 627/8 prot., datë 13.06.2024 (në gjuhën angleze protokolluar me nr. 627/9 prot., datë 13.06.2024), me një kërkesë për informacion, prodhuesit SSANGYONG MOTOR COMPANY, KG MOBILITY, në adresat e emailit (symc_ir@smotor.com/ joonbum.kim@smotor.com/ kihun1.kim@smotor.com) dhe distributorit të autorizuar SYMI S.P.A, në adresën e emailit (info@ssangyong-italia.it), duke i drejtuar pyetjen, se “*Sa është kohëzgjatja e karikimit të plotë prizë normale 0 – 100 %*”.

Në datën 28.06.2024 në postën elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik Kpp_info@kpp.gov.al, protokolluar me tonën me nr. 627/10 prot., datë 28.06.2024, ka mbërritur kthim - përgjigje nga diego.fiorenzoli@koelliker.it, i cili citon:

AC charging (“slow charge”), with 6,6kwh on-board-charger, from 0% to 100%:

- ***Using cable with Type-2 plug – charging time: +/- 11 hours***
- ***Using domestic cable with Schuko plug – charging time: +/- 30 hours***
- ***Both cables are embedded with the neë vehicle***

DC charging (“fast charge”) up to 100kwh, from 20% to 80%:

- ***Using Combo-CCS2 connector***
- ***Charging time: +/- 33 minutes***

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, në Shtojcën 5 “Specifikimet teknike” përcaktohet, se “**Në respektim të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”, duke pranuar kështu, në rastin konkret, në kuptim të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe metoda të tjera karikimi. Konkretisht, nga verifikimi i katalogut të dorëzuar nga operatori ekonomik “Tiranë Auto” SHPK, konstatohet, se për këtë model automjeti, ofrohet ***karikimi standard nga 0 në 100% – Single phase 30h (IC-CPD) / 11h (7kW); si dhe karikimi i shpejtë (20% to 80%) – 100kW: 33 min / 50kW: 54 min;****

Gjithashtu, distributori i autorizuar SYMI SPA, në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, deklaroi, se modeli i automjetit “Korando” *AC charging (“slow charge”), with 6,6kwh on-board-charger, from 0% to 100%: • Using cable with Type-2 plug – charging time: +/- 11 hours; • Using domestic cable with Schuko plug – charging time: +/- 30 hours • Both cables are embedded with the neë vehicle*
DC charging (“fast charge”) up to 100kWh, from 20% to 80%: • Using Combo-CCS2 connector; • Charging time: +/- 33 minutes

Sa më sipër, referuar objektit të prokurimit dhe specifikës së tij, duke qenë se operatori ekonomik ofertues, ka ofruar një model automjeti, për të cilin me anë të dokumentacionit të dorëzuar provon, se mund të ofrojë një kohë karikimi shumë të shpejtë, nga 20 % deri në 80 %, konkretisht me një prizë **100kW: 33 min / 50kW: 54 min**, rrjedhimisht, krijon bindjen se specifikimi teknik mbi karikimin nga 0 deri në 100 % mund të përmbushet në një kohë më të shpejtë se kërkesa e autoritetit kontraktor (7 orë).

Vlen të theksojmë, se në çdo rast është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, që në momentin e marrjes në dorëzim të mallit objekt - prokurimi, të kërkojë nga operatori ekonomik që të vërtetojë përmbushjen e këtij specifikimi teknik.

Sa më sipër, gjykojmë, se për sa kohë, me anë të dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK, si dhe nga verifikimi dhe korrespondenca me distributorin e autorizuar, vërtetohet se modeli i ofruar nga operatori ekonomik mundëson një metodë ekuivalente karikimi më të shpejtë, e cila përmbush qëllimin e autoritetit kontraktor, rrjedhimisht ky specifikim teknik do të konsiderohet i përmbushur nga ana e operatorit ekonomik “Tirana Auto” SHPK.

Akoma më tej, vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 “Sigurimi i ofertës” i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 36 “Sigurimi i kontratës”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, si dhe nenit 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Car Rentals” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Tirana Auto” SHPK, me pretendimin, se citojmë “Gjithashtu ne katalogun e dorezuar nga kompania Tirana Auto nuk gjejne pasqyrim te gjitha specifikimet teknike te Shtojces 5 te dokumenteve te tenderit.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se,

III.3.1. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale, duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës”, sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se cilat nga specifikimet teknike nuk përmbush operatori ekonomik “Tirana Auto” SHPK. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik, refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim, i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Albania Car Rentals” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-92041-12-22-2023, me objekt: Loti 1 “*Marrje Mjetesh Rrugore me Qira Operacionale (leasing), autoveturë elektrike*”, me fond limit 252,325,080 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 25.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Car Rentals” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri